

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ALENTRE” SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 03.07.2012, unë, i nënshkruari:

**Gëzim Kaziu**, i biri i Ismail, lindur në Durrës, i datëlindjes 13.12.1967,  
me numër identifikimi 024707808

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“ALENTRE” SHPK**.

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj dhe me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

**Neni 2: Selia**

Selia e shoqërisë do të jetë: **Lagjja 14, Rruga Asti Nushi, pranë Kolaudimit, Shkozë, Durrës.**

Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar.



### **Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

Ndërtimin dhe projektimin e objekteve të ndryshme, ekonomike, civile, industriale, turistike, bujqësore dhe ushtarake si banesa, komplekse turistike, zyra, hotele, pishina etj, investime dhe kryerjen e shërbimeve në këto sektorë pune, transaksione të çdo lloji për vete dhe për të tretët, konsulenca tregtare, agjensi turistike, agjensi imobiliare e përfaqësime si dhe çdo veprimtari tjetër të lejueshme nga legjislacioni shqiptar për formën juridike të shoqërisë

### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është **1.000 (njëmijë)** Lekë, i ndarë në 100 kuota, me vlerë nominale 10 lekë secili. Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**Gëzim Kaziu** është zotërues i 100 kuotave, me vlerë 1.000 lekë, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë.

### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z.Gëzim Kaziu**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.



### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.  
Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

**Gëzim Kaziu**

*Gëzim Kaziu* 